

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6179
E martë, 1 dhjetor 2020
çmimi 0.40

BE-ja kërkon nga Kosova rritje të përpjekjeve për sundim të ligjit, s'ka asgjë të re për liberalizim vizash



FAQE 7

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË PODUJEVËS, MESAZH I QARTË PËR PUSHTETIN QENDROR

FAQE 4-5

REZULTATI I PODUJEVËS MUND T'I PËRSHPEJTOJË ZGJEDHJET E REJA

Njohësit e rrethanave politike kanë vlerësuar se rezultati i zgjedhjeve në Komunën e Podujevës mund ta përshpejtojë mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Kosovë. Ata kanë bërë me dije se zgjedhjet në këtë komunë janë mesazh i qartë për pushtetin qendror në Kosovë. Sipas tyre, subjektet politike duhet të pajtohen sa më shpejt për mbajtjen e zgjedhjeve të reja në Kosovë. Analistët politikë kanë deklaruar për "Epokën e re" se sa më shumë të zvarritet mbajta e këtyre zgjedhjeve aq më keq do të jetë për partitë e koalicionit qeverisës



AKTUALE



NIS SHPËRNDARJA E VAKSINAVE KUNDËR GRIPIT SEZONAL F. 7

RAPORTI 24-ORËSH I IKSHPK-së: 11 TË VDEKUR DHE 539 RASTE TË REJA ME COVID F. 3

PREJ SOT NË PRISHTINË TRAFIKU URBAN FALAS F. 10

EKONOMI



KEK-u TEJKALON PLANIN E PRODHIMIT F. 8

MBI 100 BIZNESE DO TË PËRFITOJNË 2 MILIONË EURO NGA PROGRAMI PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE F. 8

ODA E AFARIZMIT KËRKON NGA QEVERIA LARGIMIN E KUFIZIMEVE TË ORARIT TË PUNËS PËR BIZNESET F. 9

SPORT

BALLKANI NUK GABON NDAJ ARBËRISË, LLAPI TRIUMFON NË DRENICË F. 12



OPOZITA KRITIKON QEVERINË HOTI PËR MENAXHIMIN E PANDEMISË

Deputetët e opozitës kanë kritikuar ashpër qeverinë e drejtuar nga Avdullah Hoti për menaxhimin e pandemisë. Ata kanë thënë se gjendja me Covid-19 në vendin tonë është alarmante. Sipas tyre, për shkak të numrit të madh të rasteve me Covid, QKUK-ja dhe spitalet janë buzë kolapsit. Ndërsa kryeministri Hoti, duke iu

kundërpërgjigjur kritikave të deputetëve opozitarë, ka thënë se Kosova nuk është para kolapsit, por në gjendje emergjente shëndetësore sa i përket situatës epidemiologjike. Hoti është shprehur se të gjitha klinikat janë riorganizuar në mënyrë që të përballen me valën e dytë të pandemisë F. 3

GËRMIMET NË KIZHEVAK DO TË VAZHDOJNË EDHE GJATË DITËVE NË VIJIM F. 6



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERNATIONAL VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DRENA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Mali i Zi nuk do ta tërheqë vendimin për dëbimin e ambasadorit serb

PODGORICË, 30 NËNTOR - Mali i Zi nuk do ta tërheqë vendimin për dëbimin e ambasadorit serb, Vladimir Bozhoviq, kanë njoftuar zyrtarë nga Ministria e Punëve të Jashtme e Malit të Zi. Në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë", është thënë se gjitha procedurat në lidhje me dëbimin e Bozhoviqit kanë përfunduar dhe se ai duhet ta lëshojë Malin e Zi më së largu më 1 dhjetor. Duke komentuar vendimin e Serbisë për të tërhequr vendimin për dëbimin e ambasadorit malazez, Ministria e Jashtme në Podgoricë ka theksuar se ambasadori, Tarzan Millosheviq përfaqëson vendin e tij, duke respektuar Republikën e Serbisë, pa ndërhyrë në punët e saj të brendshme, "ndryshe nga ambasadori serb në Malin e Zi, i cili vazhdimisht ka vënë në dyshim pavarësinë e Malit të

Zi me interpretimet e tij të historisë". Teksa ka bërë të ditur me dije lajmin për tërheqje të vendimit për dëbim të ambasadorit malazez, kryeministria e Serbisë, Ana Bërnabiq ka thënë se "raportet e mira me Malin e Zi janë mbi të gjitha më të rëndësishmet për ne". Presidenti serb, Aleksandër Vuçiq tha se Serbia "ka bërë një veprim të mirë" duke shtuar se i takon asaj të tregojë se dëshiron "raporte të mira dhe vëllazërore" me Malin e Zi. Serbia e shpalli ambasadorin e Malit të Zi, person non grata (të padëshiruar) dhe urdhëroi dëbimin e tij nga vendi më 28 nëntor, pasi të njëjtin veprim e kishte bërë Mali i Zi me ambasadorin serb në Podgoricë. Kryeministri në ardhje i Malit të Zi, Zdravko Krivokapiq, më herët e ka kritikuar qeverinë në largim për

vendimin, vetëm disa ditë para se të votohet nga parlamenti qeveria e re, që ka një orientim pro-serb. "Akte të tilla nuk janë në frymën e rrugës evropiane dhe bashkëpunimit të mirë rajonal të vendeve mike", ka shkruar Krivokapiq në llogarinë e vet në "Twitter". Ai ka thënë se regjimi në largim, madje edhe në ditët e tij të fundit, nuk "iu shmang polarizimit të shoqërisë dhe thellimit të ndarjeve". Si arsye për shpalljen person non grata dhe dëbimin e ambasadorit serb, ministria e Jashtme e Malit të Zi ka përmendur "ndërhyrjen e gjatë dhe të vazhdueshme në punët e brendshme të Malit të Zi". Mali i Zi mbetet thellësisht i ndarë midis atyre që kërkojnë lidhje më të ngushta me aleatët tradicionalë: Serbinë dhe Rusinë, dhe ata që e shohin Malin e Zi si një shtet të pavarur aleat me Perëndimin. Mali i Zi dhe Serbia ishin pjesë e një



vendi të përbashkët para një referendumi më 2006 që çoi në pavarësimin e Malit të Zi. Vendi tani do të drejtohet nga një koalicion pro-serb që do të votohet gjatë një seance parlamentare këtë javë, pas humbjes së Partisë Demokratike të Socialistëve pro-Perëndimore në pushtet. Partia më e fuqishme e koalicionit është Fronti

Demokratik (DF), i cili kërkon lidhje më të ngushta me Serbinë dhe Rusinë dhe mbështetet nga Kisha Ortodokse Serbe. Partnerët e tij, megjithatë, insistojnë që Mali i Zi të mbetet në kursin e tij properëndimor. Krivokapiq ka thënë se qeveria e re do të punojë për të përmirësuar marrëdhëniet e Malit të Zi me Serbinë.

Joe Biden emëron vetëm gra në ekipin e tij të komunikimit



WASHINGTON, 30 NËNTOR - Presidenti i ri i zgjedhur amerikan, Joe Biden, ndryshe nga paraardhësit e tij, ka emëruar vetëm gra në ekipin e komunikimit. Ekipi i komunikimit në Shtëpinë e Bardhë ka qenë kryesisht i dominuar nga burra, ashtu si edhe shumica e ekipeve tjera në administratë. Por, ekipi i komunikimit në administratën e Biden do përfshijë vetëm gra. Ndërkohë

është bërë me dije se sekretare për shtyp e Bidenit është emëruar zëdhënësja demokrate, Jen Psaki. Psaki do të jetë një nga shtatë gratë që do të plotësojnë radhët e ekipit të komunikimit të Bidenit, duke e bërë atë të parën që mban këtë post me të gjithë ndihmësit e tjerë të ngarkuar të flasin për një administratë presidenciale, gra. Ekipi për shtyp i Bidenit do të drejtohet nga Kate

Bedingfield, e cila ka punuar si menaxhere e komunikimit të fushatës së presidentit të zgjedhur. Ajo do të mbajë po të njëjtin titull nën administratën e Biden. Vendimi për të krijuar personelin e parë të lartë të komunikimit me të gjitha gra, mund të jetë një mënyrë tjetër që Biden ka vendosur t'i tregojë publikut përkushtimin e tij për diversitetin brenda administratës së tij.

BE-ja synon sanksionimin e aktorëve shtetërorë për përhapje të dezinformatave

Bruksel, 30 nëntor - Komisioni Evropian (KE) do të propozojë për herë të parë që Bashkimi Evropian (BE) të vendosë sanksione ndaj aktorëve shtetërorë që përhapin dezinformata, teksa shtyn përpara një mekanizëm më të ashpër të mbikëqyrjes për platformat online, bazuar në një draftdokument të parë nga "Radio Evropa e Lirë". Plani evropian i veprimit për demokraci, të cilin Komisioni Evropian do ta prezantojë më 2 dhjetor, ka thënë se bllokut evropian "i duhet të përdorë në

mënyrë më sistematike, mjetet që ka për luftim të ndërhyrjes së jashtme dhe t'i zhvillojë ato më tej, duke vendosur çmim ndaj organizatorëve". "Mënyrat e mundshme për ta bërë një gjë të tillë dallojnë nga identifikimi i teknikave të përdorura bashkërisht, e deri te vendosja e sanksioneve ndaj veprimeve të përsëritura", është thënë në dokument. Kjo është hera e parë që Komisioni Evropian ka sugjeruar vendosjen e sanksioneve për përhapje të dezinformimit. Duke paralajmëruar se informacioni

mund të përdoret si armë nga aktorë të huaj, dokumenti thekson se "disa shtete të treta (në veçanti Rusia dhe Kina) janë përfshirë në operacione të shënjestruara dhe fushata të dezinformimit për koronavirus në BE, në vendet fqinje dhe në nivel global, duke tentuar të dëmtojnë debatin demokratik dhe të përmirësojnë imazhin e tyre". Dokumenti po ashtu sugjeron rregulla më të ashpra të BE-së në platformat online "të cilat mund të përdoren nga operatorë me qëllim të keq për shpërndarjen e përmbajtjes së



reme apo mashtruese dhe të cilat janë kritikuar për mungesë të transparencës në përdorimin

e algoritmave për shpërndarje të përmbajtjes online".

Opozita kritikon qeverinë Hoti për menaxhimin e pandemisë

Deputetët e opozitës kanë kritikuar ashpër qeverinë e drejtuar nga Avdullah Hoti për menaxhimin e pandemisë. Ata kanë thënë se gjendja me Covid-19 në vendin tonë është alarmante. Sipas tyre, për shkak të numrit të madh të rasteve me Covid, QKUK-ja dhe spitalet janë buzë kolapsit. Ndërsa kryeministri Hoti, duke iu kundërpërgjigjur kritikave të deputetëve opozitarë, ka thënë se Kosova nuk është para kolapsit, por në gjendje emergjente shëndetësore sa i përket situatës epidemiologjike. Hoti është shprehur se të gjitha klinikat janë riorganizuar në mënyrë që të përballen me valën e dytë të pandemisë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Deputetët e partive opozitare në Kuvendin e Kosovës gjatë seancës plenare të së hënës e kanë kritikuar qeverinë për menaxhimin e situatës epidemiologjike në Kosovë.

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bekim Haxhiu, ka thënë se Klinika e Pulmologjisë të dielën ka paralajmëruar se ka mungesë të furnizimeve me oksigjen. Haxhiu, partia e të cilit është në opozitë, i ka bërë thirrje kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, që ta vizitojë Qendrën Klinike Universitare dhe spitalet ku trajtohen pacientët me sëmundjen Covid-19. "Janë buzë kolapsit. Situata është alarmante", ka thënë Haxhiu, duke kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë që ta rifreskojë stafin shëndetësor. "Ministria e Shëndetësisë

urgjentisht duhet të bëjë rifreskim të stafit duke angazhuar vullnetarë, t'i angazhojë të gjithë mjekët e diplomuar dhe ta fillojë punën menjëherë me specialistët e pranuar në mënyrë vullnetare deri më 31.12.2020 dhe më pas me pagesë nga viti i ardhshëm", është shprehur Haxhiu.

Ndërsa deputetja e PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që t'u dalë në ndihmë qytetarëve të infektuar me virusin Covid-19. Ajo ka thënë se qeveria Hoti duhet të hartojë një plan për t'i ndihmuar këta pacientë, derisa ka përmendur edhe shumën prej 50 eurove që e ka ndarë Komuna e Prishtinës për këta qytetarë. "Qeveria duhet të hartojë një plan për t'i ndihmuar këta pacientë, aq më pak kur disa kuvende komunale kanë filluar t'i obligojnë komunat e tyre, në mënyrë simbolike t'u dalin në ndihmë qytetarëve të vet me 50 euro", ka thënë ajo.

Deliu-Kodra ka thënë se pacientët çdo ditë ankohen për terapitë që po u kushtojnë shumë, andaj edhe i kërkoj kryeministrit Hoti që të reflektojë për këtë. "Konsideroj se kryeministri duhet të mendojë kur kemi numrin e të infektuarve në rritje çdo ditë e më shumë", ka theksuar deputetja e PDK-së.

Në anën tjetër, deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Fatmire Mullhaxha-Kollçaku, ka thënë se qeveria duhet të fokusohet te trajtimi, duke shtuar se qytetarët nuk po kanë mundësi të trajtohen për shkak të shpenzimeve enorme. "Në QKMF (Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare) nuk jepet asgjë nga terapia, ndërsa milionat po shkojnë te sektori privat. Nuk kam asgjë kundër, por shkon shikoni, bëni një

analizë sa shpenzime bëhen në baza ditore nga xhepi i varfër i qytetarëve. Mbulojini së paku kategoritë në nevojë", është shprehur ajo.

Ndaj këtyre kritikave ka reaguar kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti. Ai ka thënë se Kosova nuk është para kolapsit, por është në gjendje emergjente shëndetësore sa i përket situatës epidemiologjike. Hoti është shprehur se të gjitha klinikat janë riorganizuar në mënyrë që të përballen me valën e dytë të pandemisë. "Kemi ndërmarrë masat e nevojshme sikurse çdo vend në rajon edhe në BE-në. E kemi përmirësuar furnizimin me barna, është dukshëm më i mirë tani kur po flasim, por kam parasysh se plot familje shpenzojnë edhe nga xhepi i tyre", ka thënë Hoti, duke shtuar se Kosova po e ndanë "fatin e

vendeve të tjera". "Po punojmë shumë për sigurimin e vaksinës kundër Covid-19 përtej sasisë që na është garantuar", është shprehur Hoti.

Më tutje, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se gjendja në Kosovë me pandeminë "është rënduar si pasojë e rritjes dhe shpërndarjes së infeksionit edhe në rajon, edhe në vendet evropiane". "Por, ajo çfarë mund t'ju garantoj është kjo: asnjë pacient në Republikën e Kosovës nuk ka mungesë të trajtimit, qoftë spitalor, qoftë klinik apo edhe dhënies apo marrjes së shërbimeve", është shprehur Zemaj. Ai ka theksuar se Kosova ka "vdekshmërinë më të ulët edhe në rajon edhe në botë". Ministri Zemaj ka bërë me dije se gjatë kësaj jave do të dhjetëfishohen kapacitetet testuese për Covid-19.

Raporti 24-orësh i IKShPK-së: 11 të vdekur dhe 539 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 30 NËNTOR (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur 11 persona si pasojë e infektimit me Covid. Po ky institut ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur 539 raste të reja me Covid-19. "Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 1 219 mostra të marra nga ShShKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 539 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 11 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Podujevë 2 raste (75, 50 vjeç), Prizren 2 raste (75, 65 vjeç), Dragash 1 rast (64 vjeç), Drenas 1 rast (82

vjeç), Gjakovë 1 rast (77 vjeç), Gjilan 1 rast (44 vjeç), Malishevë 1 rast (63 vjeç), Pejë 1 rast (65 vjeç), Rahovec 1 rast (82 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 39 596 raste nga 143 988 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 1 016 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 574 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 25 001 raste, kurse numri i rasteve aktive është 13 579", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar numrin e rasteve sipas komunave. "Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 179 raste, Gjilan 63 raste, Mitrovicë 50 raste, Gjakovë 40 raste, Viti 26 raste, Pejë 24 raste, Ferizaj 22 raste, Fushë-Kosovë 13 raste, Vushtrri 13 raste, Kamenicë 12 raste, Skenderaj 12 raste,



Drenas 11 raste, Lipjan 10 raste, Obiliq 10 raste, Prizren 9 raste, Klinë 7 raste, Suharekë 6 raste, Istog 5 raste, Malishevë 5 raste,

Shtime 4 raste, Deçan 3 raste, Kaçanik 3 raste, Rahovec 3 raste, Zubin-Potok 3 raste, Graçanicë 2 raste dhe me nga 1

rast komunat Hani i Elezit, Klokot, Novobërdë dhe Podujevë", ka njoftuar IKShPK-ja.



ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË PODUJEVËS, MESAZH I QARTË PËR PUSHTETIN QENDROR

REZULTATI I PODUJEVËS MUND T'I PËRSHPEJTOJË ZGJEDHJET E REJA

Njohësit e rrethanave politike kanë vlerësuar se rezultati i zgjedhjeve në Komunën e Podujevës mund ta përshpejtojë mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Kosovë. Ata kanë bërë me dije se zgjedhjet në këtë komunë janë mesazh i qartë për pushtetin qendror në Kosovë. Sipas tyre, subjektet politike duhet të pajtohen sa më shpejt për mbajtjen e zgjedhjeve të reja në Kosovë. Analistët politikë kanë deklaruar për "Epokën e re" se sa më shumë të zvarritet mbajta e këtyre zgjedhjeve aq më keq do të jetë për partitë e koalicionit qeverisës

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 30 DHJETOR - Njohësit e rrethanave politike në vend kanë bërë me dije se rezultati i zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Podujevës tregon se zgjedhjet e reja në nivel vendi janë të pashmangshme. Ata kanë deklaruar se mesazhet që dërguan qytetarët e kësaj komune për koalicionin qeverisës ishin të qarta. Analisti politik Imer Mushkolaj ka thënë për "Epokën e re" se ky rezultat mund ta përshpejtojë mbajtjen e zgjedhjeve nacionale. "Rezultati që ka dalë nga zgjedhjet për kryetar të Komunës së Podujevës është tregues shumë i qartë se LDK-ja duhet të dorëzohet dhe të merret vesh me partitë e tjera

për ta çuar vendin në zgjedhje të reja", ka thënë Mushkolaj. Ai ka vlerësuar që sa më shpejt të mbahen zgjedhjet e reja aq më mirë është edhe për partitë e koalicionit qeverisës. "E kuptoj se ky rezultat do t'i frikësoj edhe më shumë partitë e koalicionit qeverisës. Por, kurdo që ato zgjedhje do të mbahen, rezultati i tyre do të shkojë në dëm të këtyre partive. Sa më shpejt që mbahen zgjedhjet është më mirë për partitë e koalicionit. Përndryshe, nëse vazhdojnë duke e arnuar qeverinë dhe duke vazhduar me arrogancë qeverisjen, besoj se do të dalin më keq në zgjedhje", është shprehur ai, duke shtuar se fryma që po mbretëron tani te qytetarët do të shkojë duke u rritur. "Ajo çfarë ka ndodhur në Podujevë ka treguar një frymë që është duke mbretëruar te

qytetarët e Kosovës. Kjo frymë do të vijë duke u forcuar e jo duke u zbehur. Qysh po shihet, qeverisja në vend nuk do të vijë duke u përmirësuar, sepse sfidat do të jenë edhe më të mëdha. Kështu që, në bazë të kësaj logjike, sa më shumë të zvarriten zgjedhjet e reja, do të jetë më keq për partitë e koalicionit qeverisës", ka deklaruar Imeri. Edhe analisti tjetër politik Blerim Latifi ka thënë se gara për Podujevën nuk ishte në mes të kandidatit të Lëvizjes Vetëvendosje dhe atij të LDK-së. "Gara në Llap nuk ishte midis Bulliqit dhe Rudarit. Ishte midis Kurtit dhe Veliut. Kurti e ka në dorë një kartë me të cilën do t'i mund të gjithë në zgjedhje: imazhin e politikanit të pakorruptueshëm. Dhe derisa nuk e konsumon një mandat në pushtet, ky imazh i tij veç do të

vazhdojë të fuqizohet. Kot ia përplasim fytyrës shkeljet e abuzimet që zyrtarë të tij i bëjnë herë pas here", ka shkruar ai në "Facebook".

Kurse opinionisti Dardan Sejdiu ka vlerësuar se ky rezultat i bën zgjedhjet e parakohshme nacionale të domosdoshme. "Urime Shpejtim Bulliqit dhe Lëvizjes Vetëvendosje për fitoren në zgjedhjet lokale në Podujevë! Rezultati në Podujevë tregon se zgjedhjet edhe në nivel nacional janë të domosdoshme", ka shkruar Sejdiu në profilin e vet në "Facebook".

Rezultatit e zgjedhjeve në Komunën e Podujevës e ka komentuar edhe analisti tjetër politik Jusuf Thaçi. "Humbja e LDK-së në Podujevë, në bastion, pa balotazh, madje me diferencë të madhe, tregon se për masakrën që i ka bërë vullnetit qytetar më 6 tetor 2019, LDK-ja do të ndëshkohet fuqishëm nga qytetarët në zgjedhjet e ardhshme parlamentare", ka shkruar ai në "Facebook". Sipas tij, zgjedhjet e reja duhet të organizohen sa më shpejt. "Kjo humbje e LDK-së është delegjtimim i fundit i qeverisë aktuale të Kosovës. Prandaj, zgjedhjet parlamentare duhet të organizohen sa më parë në Kosovë. Sa më gjatë që do t'i prolongojnë këto zgjedhje aq më

shumë mund të ndëshkohen", ka shkruar ai.

Fitorja e thellë e LV-së në komunën që ishte bastion i LDK-së për dekada, ka entuziazmuar edhe zyrtarët e partisë së Albin Kurtit. Anëtarja e Kryesisë e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se partitë politike të cilat e injorojnë vullnetin e popullit do ta pësojnë më keq në zgjedhjet e ardhshme nacionale dhe lokale. "Sa më shumë që injorojnë mesazhin dhe vullnetin e popullit aq më keq do ta pësojnë në zgjedhjet e ardhshme nacionale e lokale. Ndryshe, mbrëmë për herë të parë pas dy dekadash qeverisje, Lidhja Demokratike e Kosovës pësoi humbje në zgjedhjet për kryetar të komunës. Shpejtim Bulliqi i LV-së e mundi bindshëm Nexhmi Ruadrin e LDK-së, duke bërë që pas shumë vitesh të ndryshojë qeverisja në Llap", ka shkruar Haxhiu.

Vlerësohen zgjedhjet në Podujevë dhe Mitrovicë të Veriut

Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut janë vlerësuar lart nga

mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë. Pas mbylljes së procesit të votimit, KQZ-ja ka vlerësuar se procesi zgjedhor në këto dy komuna ishte zhvilluar pa problem. Edhe ushtruesja e detyrës e presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, ka reaguar pas zgjedhjeve në Podujevë dhe në Mitrovicë të Veriut. Osmani nëpërmjet një mesazhi drejtuar mediave ka thënë se Republika e Kosovës ka dëshmuar se është e aftë të organizojë zgjedhje të lira, fer dhe demokratike. "I uroj të gjithë qytetarët e Podujevës dhe ata të Mitrovicës së Veriut për maturinë e treguar gjatë tërë këtij procesi, përkundër faktit se u realizua në kohë pandemie. Përgëzoj Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe të gjithë të angazhuarit e tjerë për punën dhe angazhimin e madh me të cilin u arrit organizimi i zgjedhjeve sipas standardeve demokratike. Falënderoj, po ashtu, përfaqësuesit e shoqërisë civile për angazhimin për vëzhgimin e këtyre zgjedhjeve si dhe mediat për raportimin nga

Gashi i LDK-së: Jemi të gatshëm për zgjedhje

Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashi, ka thënë se zgjedhjet janë opsion në demokraci dhe se partia e tij është e gatshme për zgjedhje. "Rezultati i Podujevës është rezultat jo i kënaqshëm për ne dhe normalisht do të merremi me analiza për të parë se ku janë problemet dhe për t'i evituar ato në zgjedhjet e ardhshme lokale që do të jenë pas 10 muajsh. Në proces diku ka ndodhur një shkopje me elektoratin", ka deklaruar

Gashi, pas mbledhjes së kryesisë së LDK-së. I pyetur se a i humbën zgjedhjet në Podujevë për shkak të deklaratave të zëvendëskryeministrit Driton Selmanaj ndaj deputetes së Lëvizjes Vetëvendosje, Saranda Bogujevci, Gashi ka thënë se s'mund të personalizohen gjërat. "Nuk mendoj se personalizohen në proces ka ndodhur diku një shkopje dhe do ta shikojmë", ka deklaruar Gashi.

këto dy komuna", ka thënë në mesazhin e Osmanit.

Ndërsa shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, në "Twitter" ka shkruar

se përfshirja aktive e qytetarëve është e rëndësishme për procesin e besueshëm të zgjedhjeve dhe demokracinë. "I vlerësoj votuesit që morën pjesë

në Podujevë dhe Mitrovicën e Veriut në ditën e zgjedhjeve të prekur nga kufizimet ndaj Covid-19. Përfshirja aktive e qytetarëve është e rëndësishme për procesin e besueshëm të zgjedhjeve dhe demokracinë. Punë e mirë e bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve", ka shkruar Szunyog. Sipas rezultateve preliminare të KQZ-së, kandidati i Lëvizjes

Vetëvendosje, Shpejtim Bulliqi, i ka fituar zgjedhjet në Podujevë me 51.64 për qind të votave. Ndërsa kandidati i Listës Serbe, Milan Radojeviq, ka fituar Mitrovicën e Veriut me 89.86 për qind të votave. Në Komunën e Podujevës në këtë proces zgjedhor kanë votuar 40.51 për qind e votuesve, kurse në atë të Mitrovicës së Veriut kanë votuar 39.14 për qind e votuesve.

Molliqaj: Mashtrimi i madh i populizmit antikorrupsion do të vazhdojë

Kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Molliqaj, ka reaguar pas fitores së LV-së në Podujevë, duke e cilësuar të pritshëm rezultatin e këtyre zgjedhjeve. Në profilin e tij në "Facebook", ai ka shkruar se mashtrimi i madh i populizmit antikorrupsion do të vazhdojë. "Rezultati i zgjedhjeve në Podujevë ishte pak a shumë i pritshëm dhe sidomos i kuptueshëm. Mashtrimi i madh i populizmit antikorrupsion do të vazhdojë edhe për një kohë. Por, një përgjigje e gabuar sillet vërdallë tash sa kohë. Këto zgjedhje provuan se përgjigjja liberale e diskutit korrekt, që flet për

normalitetin, nuk funksionon sepse nuk është e duhura. Kjo përgjigje sheshon kontradiktat për ta ruajtur status-quon. Duke bërë këtë ruan edhe interesat ekonomike dhe politike që qeverisin në mënyrë të padrejtë përditshmërinë tonë", ka shkruar ai, duke shtuar se pas kësaj fitore të LV-së, mund të rrezikohet demokracia në vend. "Kosovën e pret një rrezik mbi demokracinë. Diktatura e numrave do ta totalizojë skenën dhe diskursin. Jo vetëm si kontroll medial, por edhe si strukturë e mbyllur ideologjike, si mohim i tjetrit. Kjo betejë është në ardhje", ka shkruar Molliqaj.



AAK-ja këmbëngulë në postin e presidentit

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Nënkyetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ahmet Isufi, ka deklaruar se ky subjekt politik nuk do të lëshoj pe për postin e presidentit. Në një intervistë për "KosovaPress", ai ka treguar arsyet se pse lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, duhet të jetë president i vendit. "Besoj që do të mbahet takimi edhe do të vlerësohet situata, por edhe do të bisedohet për kandidatit e presidentit. Këtë rast mendojmë që Ramush Haradinaj i plotëson kushtet dhe rrethana të caktuara dinë të sillt si lider i vendit të vet. Këtë e ka konfirmuar me tentimin për ndarjen e Kosovës që ishte shumë i përgjegjshëm në ato situata. Po ashtu, edhe rreth krijimit të ushtrisë, ligjit për Trepçën si pasuri e Kosovës

dhe territor i Kosovës. Edhe raportet me ndërkombëtar i ka sqaruar drejtpërdrejtë ashtu siç burrështetas", ka deklaruar Isufi. Ai ka deklaruar se partitë politike duhet të heqin dorë prej interesave të ngushta partiake. "Por në fund besoj që do të jetë në shprehje racionaliteti i partive politike, i Kuvendit të Kosovës se aty votohet. Në bazë të votave që mund të ketë kandidati mund të zgjidhet. Prandaj ndodhin edhe negociatat, takimet nuk janë të lehta sepse partitë politike më së pari e shohin vetën, mandej interesat me të tjerët. Por në këtë moment kisha thënë që partitë politike duhet të heqin dorë nga interesat më të ngushta partiake. Duhet të shkojnë në atë se çka kërkon Kosova sot", është shprehur ai. Isufi është



shprehur kategorik kundër çdo mundësie që 14 deputetët e AAK-së në Kuvend të votojnë

kandidat tjetër për president, jashtë liderit të tyre partiak. Sipas tij, nëse Haradinaj nuk e

merr postin e presidentit, zgjedhjet e parakohshme mbesin e vetmja mundësi.

Selimi: Çdo proces ku janë të përfshirë të gjithë hisedarët e sistemit të drejtësisë do të jetë më lehtë i zbatueshëm

PRISHTINË, 30 NËNTOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka mbajtur të hënën një takim me kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Skender Çoçaj dhe atë të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Bahri Hyseni, me të cilët ka diskutuar për hapat e veprimit drejt finalizimit të draftit të parë të Strategjisë që del nga procesi i Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit. Gjatë këtij takimi, është dakorduar që ekipet e Ministrisë së Drejtësisë dhe dy këshillave KGJK-së dhe KPK-së, të takohen për t'i adresuar komentet dhe për të

finalizuar rekomandimet që përfshihen në strategji. "U dakorduar që të hartojmë planin e veprimit së bashku me hisedarët e drejtësisë, i cili duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe i zbatueshëm, përmes së cilit do të adresohen sfidat e sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial", ka thënë ministri Selimi. Në këtë takim është diskutuar edhe për adresimin e komenteve që kanë të bëjnë me finalizimin e Projektligjit për gjykatën komerciale, si dhe për ndryshimet e nevojshme legjislative të sistemit prokurorial.

Ministria e Drejtësisë, javën e kaluar ka prezantuar draftin e parë të konsoliduar të pjesës narrative dhe planeve të veprimit të Projektstrategjisë sektoriale të sundimit të ligjit. Ndërsa kryesuesit e KGJK-së dhe KPK-së, Çoçaj dhe Hyseni, kanë shprehur gatishmërinë e të dy këshillave për bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, me qëllim që përmes procesit të rishikimit funksional si dhe avancimit të legjislacionit të adresohen sfidat e sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial. Grupi Punues për hartimin e Projektstrategjisë sektoriale të



sundimit të ligjit e kryesuar nga Ministria e Drejtësisë, përbëhet nga përfaqësues të KGJK-së, KPK-së, Akademisë së Drejtësisë, Zyrës

se Kryeministrit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Financave dhe akterë të tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Gërmimet në Kizhevak do të vazhdojnë edhe gjatë ditëve në vijim



PRISHTINË, 30 NËNTOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka njoftuar se përfaqësues të delegacionit të Kosovës në kuadër të Grupit punues për persona të zhdukur kanë vizituar të

hënën lokacionin e varrezës masive në Kizhevak të Rashkës në Serbi. Hoti ka bërë me dije se gërmimet në Kizhevak do të vazhdojnë edhe gjatë ditëve në vijim. "Sot, përfaqësues të delegacionit të Kosovës në

kuadër të Grupit punues për persona të zhdukur, kanë vizituar lokacionin e varrezës masive në Kizhevak të Rashkës, Serbi, më rastin e rifillimit të gërmimeve. Gërmimet vlerësuese dhe

zhvarrosjet e mbetjeve mortore të viktimave të luftës së viteve 1998-'99 në Kosovë, gjegjësisht punimet në këtë lokacion, do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim. Ekspertët mjekoligjorë të

Republikës së Kosovës, në emër të delegacionit të Kosovës, do të vazhdojnë të jenë të pranishëm deri në përfundim të procesit, në përputhje me praktikën mes dy delegacioneve", ka thënë Hoti.

Vetëm disa shkolla të Prishtinës dhe Drenasit nuk e respektuan vendimin e SBASHK-ut

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Thirrjes së Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) që të mos mbahet mësimi të hënën, nuk i janë përgjigjur vetëm disa shkolla në Komunën e Prishtinës dhe të Drenasit. Ushtrues i detyrës së nënkryetarit të SBASHK-ut, Lutfi Mani, ka thënë se në Prishtinë dhe në Drenas është zhvilluar mësimi pjesërisht.

"Nuk jemi duke bërë gara se kush është më i fortë, se kemi ku ta tregojmë. Ne e tregojmë në mësim, e qeveria në mirëqenie, në punë për popullin", ka thënë Mani për "EO". Ai ka thënë se të gjithë mësimdhënësit dhe nxënësit janë njoftuar për vendimin e SBASHK-ut. Më tutje, ai ka thënë se kjo sindikatë nuk kanë pranuar

njoftim me kohë nga Ministria e Arsimit dhe Qeveria e Kosovës për vendimin që e hëna të jetë ditë pune. "Prandaj në Kosovë janë të ndara resurset, e SBASHK-u e ka partner Ministrinë e Arsimit, jo që qeverinë", ka thënë ai. Sipas të dhënave të SBASHK-ut mbi 1 mijë mësimdhënës janë infektuar me Covid-19.



BE-ja kërkon nga Kosova rritje të përpjekjeve për sundim të ligjit, s'ka asgjë të re për liberalizim vizash

Këshilli i Bashkimit Evropian e ka ftuar Kosovën t'i përmirësojë urgjentisht përpjekjet për përmirësimin e sundimit të ligjit, ta shtojë luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe t'i vazhdojë reformat në administratën publike. Po ky këshill ka kërkuar nga Kosova vazhdimin e përkushtimit ndaj Dhomave të Specializuara në përputhje të plotë me obligimet ndërkombëtare të saj



PRISHTINE, 30 NËNTOR - Këshilli i Bashkimit Evropian edhe këtë vit do t'i miratojë konkluzat për procesin e zgjerimit dhe procesin e stabilizim-asocimit me vendet e Ballkanit Perëndimor përmes të cilave do të bëjë ftesë për nevojë urgjente për reforma dhe për luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Drafti i konkluzave tashmë është përgatitur dhe teksti i tyre është në proces të miratimit nga përfaqësuesit e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Në këtë draft, tekstin e të cilit e ka parë "Radio Evropa e Lirë", Kosova ftohet që t'i përmirësojë urgjentisht përpjekjet për përmirësimin e sundimit të ligjit, ta shtojë luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe reformave të administratës publike. Nga Kosova është kërkuar edhe vazhdimin e përkushtimit ndaj Dhomave të Specializuara, në përputhje të plotë me obligimet

ndërkombëtare të saj, ligjet vendore dhe si një rrugë për të dëshmuar përpjekje të sinqerta për sundimin e ligjit, liritë themelore, drejtësi dhe pajtim. Si në pjesën kushtuar Kosovës ashtu edhe atë për Serbinë, Këshilli i bllokut evropian përmes këtyre draftkonkluzave kërkon që ta vazhdojnë angazhimin në dialog me vullnet të mirë dhe në frymën e bashkëpunimit dhe kompromisit në mënyrë që të arrihet një marrëveshje gjithëpërfshirëse, ligjrisht obliguese dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe ligjet e BE-së. Këshilli do t'i ftojë palët që të respektojnë dhe implementojnë të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tash në procesin e dialogut. "Këshilli rikujton se progresi për normalizimin e raporteve me Serbinë është një parim themelor i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe është

bazë për zhvillimin e raporteve dhe bashkëpunimit në mes të BE-së dhe Kosovës", është thënë në këtë dokument.

Nuk ka asnjë të re sa i përket liberalizimit të vizave. Në këtë draft vetëm përsëritet se "Këshilli kupton rëndësinë e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës", thuhet se "propozimi është duke u shqyrtuar në Këshill" dhe rikujtohet se Komisioni Evropian kishte propozuar qysh në vitin 2018 që Kosovës t'i hiqen vizat.

Këshilli i BE-së, siç është thënë

në tekstin e përgatitur për këto konkluzat, të cilat duhet të miratohen nga shtetet anëtare, kërkon nga Serbia që ta vazhdojë procesimin e rasteve të krimit të luftës. Po nga Serbia kërkohet që ta parandalojë glorifikimin e kriminelëve të luftës. Nga të gjitha shtetet e Ballkanit kërkohet që t'i përshtatin qëndrimet e tyre me BE-në në çështjet e politikës së jashtme sidomos për masat restriktive që BE-ja miraton për shtetet e treta. Teksti i këtyre konkluzave, që kanë edhe pjesën e

përgjithshme për rajonin, por edhe ato të veçanta për secilin vend, është një lloj i përmbljedhjes së të gjeturave të Komisionit Evropian të cilat janë botuar në paketën e zgjerimit dhe raportet e progresit të miratuara kohë më parë. Ndonëse në këtë dokument përmendet edhe pritja që "sa më parë" të nisnin negociatat e anëtarësimit mes BE-së dhe Maqedonisë së Veriut e Shqipërisë, nuk përmendet ndonjë datë se kur mund të ndodhë kjo.

Nis shpërndarja e vaksinave kundër gripit sezonal

PRISHTINE, 30 NËNTOR - Në Kosovë ka nisur shpërndarja e 160 500 vaksinave kundër gripit sezonal të cilat Ministria e Shëndetësisë e Kosovës i ka blerë përmes UNICEF-it. Ministri i Shëndetësisë i Kosovës, Armend Zemaj, ka bërë me dije se janë duke siguruar edhe 50 mijë vakcina të reja kundër gripit sezonal. "Është dyfishi i vaksinave të siguruar nga viti i kaluar dhe shpresojmë se gjithçka do të shkojë në rregull, qytetarët do të vaksinohen, grupet të cilat quhen të rrezikuara dhe janë të nevojshme që ta marrin këtë vaksinë", ka thënë Zemaj, duke shtuar se këto vakcina do të jenë falas. Ndërsa shefi i Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Murat Sahin, ka thënë se arritja e vaksinave kundër gripit sezonal është një lajm i mirë për Kosovën dhe ka shtuar se

janë duke punuar që shumë shpejt të arrijnë edhe vaksinat kundër sëmundjes Covid-19 që shkakton koronavirusi i ri. "Ne do të punojmë ngushtë për shpërndarjen e vaksinave kundër gripit sezonal. Është një ditë e rëndësishme për Kosovën. Ky është një bashkëpunim i ngushtë me Qeverinë e Kosovës. Ne, po ashtu, po punojmë ngushtë që t'i sjellim edhe vaksinat kundër Covid-19 sa më shpejt që të jetë e mundur. Kemi një grup të vogël që po punon për çështjen e vaksinave për Covid-19", është shprehur Sahini. Këtë vit është paraparë që në Kosovë të vaksinohen rreth 500 mijë njerëz kundër gripit sezonal. Infektologët në Kosovë më herët kanë thënë se është e nevojshme që qytetarët të vaksinohen kundër gripit sezonal sa më shpejt që të jetë



e mundur. Sipas infektologut Sali Ahmeti, infektimi me

gripin sezonal e ul imunitetin e njeriut, prandaj mund të

infektohen më lehtë me Covid-19.

Gastronomët kërkojnë urgjentisht nga qeveria ta heqë kufizimin e lëvizjes

PRISHTINË, 30 NËNTOR (ER) - Shoqata e Gastronomëve i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që urgjentisht të largohen masat e vendosura që lidhen me këtë sektor, pasi masat e vendosura janë treguar joefektive. Gastronomët me anë të një reagimi publik, kanë thënë se qeveria as të mos mendojë mbylljen totale pa ndonjë plan për mbështetjen financiare. Kjo shoqatë ka kritikuar festën e organizuar në mbrëmjen e 29 nëntorit në Podujevë, pas përfundimit të procesit zgjedhor. "Të shqetësuar nga rezultatet jopremtuese nga masat e fundit të aplikuar nga ana e Qeverisë së Kosovës (QK), që nga data 13 nëntor e deri më sot, jemi dëshmitar që laborja e infeksionit Covid-19 vetëm është përkeqësuar. Më shumë se kjo, kemi rritjen e lakores së dëmit ekonomik, e cila çdo herë e më shumë po thellohet. Këto politika që nga fillimi i pandemisë e deri më tani, është evidente që nuk po arrijnë qëllimin e tyre, përkundrazi të pamenduara dhe shumë të rrezikshme për vendin, që do t'i lejnë gjurmët e pasojat e tyre për një kohë të konsiderueshme edhe pas pandemisë. Sa i përket ndikimit të pandemisë dhe masave të QK-së në aspektin ekonomik, tashmë është evidente që sektori i gastronomisë është më i goditur në vend", është thënë në reagimin e Shoqatës së Gastronomëve, duke u shtuar se sipas të dhënave të Agjencionit Statistikor të Kosovës (ASK), të hyrat dhe qarkullimi i sektorit të gastronomisë në krahasim me vitin 2019 dhe 2020, vetëm në tremujorin e dytë (TM2),



rezultojnë të kenë pasur rënie prej 64 për qind, si asnjë sektor tjetër në Kosovë. "Nga dy sondazhe të bizneseve dhe punëtorëve të raportit hulumtues të ndikimit të pandemisë në gastronomi të përgatitur nga ShGK-ja dhe 'Korb Marketing&Research', kemi të raportuar që 36 për qind e bizneseve të gastronomisë, janë detyruar që të largojnë nga puna punëtorët e tyre si pasojë e zvogëlimit të vëllimit të ushtrimit të veprimtarisë dhe problemeve të likuiditetit. Nëse kjo atmosferë e shkaktuar ekonomike vazhdon edhe më tutje, bizneset nuk mund ta mbijetojnë këtë situatë dhe 56 për qind e tyre kanë raportuar që do të largojnë edhe më shumë staf nga puna. Në këto rrethana, urgjentisht ju bëjmë thirrje që këto masa të hiqen, si jo efektive, e aq më pak të mendohet mbyllja totale pa ndonjë plan për mbështetjen financiare në ekonomi", është thënë tutje në këtë reagim. Sipas

këtij reagimi, nuk duhet të harrohet se përhapja më e madhe e infeksionit ndodhë në hapësirat e institucioneve publike të cilat nuk i respektojnë masat parandaluese. "Nuk inspektojnë hapësirat e tyre të brendshme, por që kanë fokus primar dënimin e bizneseve private dhe këmbësorëve, duke shkaktuar papunësi të madhe në sektorin privat, derisa bëjnë çmos për të garantuar që pagat dhe mëditjet e tyre të mos u preken. Për të përfunduar, të gjitha këto dhe i tërë serioziteti i kësaj çështjeje, përveç tjerash shpjegohet më së miri me mesazhin që kemi kuptuar të gjithë me turmat e pakontrolluara të njerëzve, mbledhjet, organizimet dhe fushatat e padinjitetshme të politikanëve në zgjedhjet e fundit në Podujevë, etj. Pra, ky është shembulli që marrim në këtë kohë krize e fatkeqësie! Turp ju qoftë!", është thënë në reagimin e Shoqatës së Gastronomëve të Kosovës.

Mbi 100 biznese do të përfitojnë 2 milionë euro nga programi për rimëkëmbje ekonomike

PRISHTINË, 30 NËNTOR (ER)- Kryeministri Avdullah Hoti dhe ministri i Zhvillimit Rajonal, Enis Kervan, kanë marrë pjesë në nënshkrimin e kontratës për financim të projekteve nga masa e 8-të e Programit për rimëkëmbje ekonomike. Vlera e projekteve do të jetë 2 milionë euro dhe përfituese do të jenë 156 biznese. Me këtë rast, Hoti ka thënë se është inkurajues fakti që rreth 500 punëtorë do të përfitojnë nga kjo masë. "Bëhet fjalë për rreth 500 punëtorë që do të përfitojnë nga bizneset tuaja. Shpresoj që kjo masë është një lehtësim për bizneset e vogla dhe të mesme. Kemi marrë edhe masa tjera përfshirë atë

për 60 milionëshit dhe atë për bujqësi. Kurse një masë ka qenë për bizneset jo shumicë", ka thënë Hoti, duke shtuar se edhe vitin e ardhshëm do të ketë ndihmesa për bizneset. "Jemi të detyruar që edhe vitin e ardhëm të parashohim masa të tjera dhe besoj që ndihmesat do të rriten. Ne po bisedojmë edhe me donatorë të jashtëm. Ne gjatë kësaj periudhe jemi munduar që t'i qëndrojmë afër familjeve e bizneseve. Do ta keni mbështetjen e plotë të qeverisë deri sa ta kalojmë këtë periudhë të vështirë. Komplet Fondin për ekonomi deri në fund të vitit do ta fusim në ekonomi", ka theksuar Hoti. (A.MAVRAJ)



Miratimi i Projektligjit për rimëkëmbjen ekonomike duhet ta ketë një epilog vendimtar këtë javë

PRISHTINË, 30 NËNTOR (ER)- Kryetari Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka thënë se beteja për miratimin e Projektligjit për rimëkëmbjen ekonomike nga pandemia Covid-19 duhet ta ketë një epilog vendimtar këtë javë, ndryshe sipas tij e humb kuptimin. Rukiqi me anë të një shkrimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka treguar se, argumentet dhe propozimet duhet të vendosen në variantin përfundimtar të Projektligjit.

"Beteja e parë për rimëkëmbjen, përkatësisht miratimi i Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike duhet ta ketë një epilog vendimtar këtë javë. Ndryshe e humb kuptimin. Kemi dëgjuar mjaft ekspertizë,



argumente dhe propozime të cilat mund ta pasurojnë Ligjin për Rimëkëmbjen, përfshirë

propozimet shumë nga përmbajtjesore përfaqësuesit e biznesit, partitë

politike në pozitë dhe opozitë, ekspertet dhe institutet e ndryshme (Kryetari i Komunës të Prishtinës, GAP, Riinvest, Dardan Sejdiu, etj.). E gjithë kjo ekspertizë dhe propozimet e ndryshme duhet të inkuropohen në variantin përfundimtar të Ligjit. Ligji nuk krijon mrekulli ekonomike, por krijon bazë për të rikthyer konfidencën e humbur te bizneset dhe konsumatorët. Kthimi i konfidencës është parakusht që qytetarët të rrisin konsumin, e në anën tjetër bizneset të rrisin investimet dhe të ruajnë vendet e punës", ka shkruar Rukiqi.

Kryeministri Avdullah Hoti javën që lamë pas premtoi se këtë javë

do të kalojë ky Projektligj. Projektligji është votuar në Kuvendin e Kosovës në lexim të parë pas tentativës së shtatë, ndërsa tashmë ka dështuar dy herë të miratohet në lexim të dytë.

Ndryshe, më 12 tetor, pas gjashtë dështimeve, Kuvendi i Kosovës me 64 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, kishte votuar në lexim të parë këtë Projektligj.

Nëse Projektligji siguron votat e nevojshme edhe në lexim të dytë, kryetarja e Kuvendit e nënshkruan dhe e dërgon tek Presidenti për shpallje. Ndërkaq, Presidenti ka afat tetë ditë për ta shpallur ose për ta kthyer atë për rishqyrtim në Kuvend.

KEK-u tejkalon planin e prodhimit

Ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të KEK-ut, Luigj Imeri, ka deklaruar se pavarësisht vjetërsisë së makinerive për nxjerrjen e thëngjillit dhe të njësive prodhuese të energjisë, ato kanë performuar shumë mirë, duke tejkaluar kapacitetet e prodhimit. “Termocentrali ‘Kosova A’, në kuartalin e tretë ka realizuar planin e vet të prodhimit 107 për qind edhe përkundër vjetërsisë që ka. Në anën tjetër edhe termocentrali ‘Kosova B’, ka realizuar planin e vet të prodhimit me rreth 116 për qind. Për më tepër, funksionimi i këtyre termocentraleve bëhet edhe duke u furnizuar me qymyr, që nënkupton se nuk ka pas kurrfarë pengese dhe divizioni i qymyrit e ka realizuar planin e vet duke i furnizuar dy termocentralet e korporatës energjetike me qymyr”, ka thënë Imeri



EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 30 NËNTOR- Korporata Energjetike e Kosovë (KEK), ka bërë me dije se e ka mbyllur tremujorin e tretë të këtij viti me sukses të plotë. Përkundër situatës së vështirë të shkaktuar nga pandemia Covid-19, KEK-u ka arritur ta tejkalojë planin e paraparë të prodhimit. Ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të KEK-ut, Luigj Imeri, ka deklaruar se pavarësisht vjetërsisë së makinerive për nxjerrjen e thëngjillit dhe të njësive prodhuese të energjisë, ato kanë performuar shumë mirë.

“Termocentrali ‘Kosova A’, në kuartalin e tretë ka realizuar planin e vet të prodhimit 107 për qind edhe përkundër vjetërsisë që ka. Në anën tjetër edhe termocentrali ‘Kosova B’, ka realizuar planin e vet të prodhimit me rreth 116 për qind. Për më tepër, funksionimi i këtyre termocentraleve bëhet edhe duke u furnizuar me qymyr, që nënkupton se nuk ka pas kurrfarë pengese dhe divizioni i qymyrit e ka realizuar planin e vet duke i furnizuar dy termocentralet e korporatës energjetike me qymyr”, ka deklaruar Imeri. Falë performancës së mirë në termocentralin “Kosova B”, është arritur që të realizohet edhe plani

i furnizimit me energji termike për Termokosin, e cila energji shërben për ngrohjen e qytetarëve të kryeqytetit. Megjithatë të gjitha këto rezultate, sipas Imerit janë arritur falë punës dhe angazhimit të madh të të gjithë punëtorëve të KEK-ut. “Për këtë rezultat, për këtë performancë dhe për këtë punë të cilën është bërë me plotë sfida gjatë këtij viti, nuk mundem pa përmendur dhe pa i falënderuar të gjithë punonjësit e Korporatës Energjetike të Kosovës, të cilët kanë dhënë dhe kanë bërë maksimumin e mundshëm duke i kursyer kolegët e tyre, të cilët kanë qenë me sëmundje kronike, duke i liruar nga vendet e tyre të

punës dhe duke u mbuluar puna nga kolegët e tyre, të cilët nuk kanë lënë të vërehet mungesa e tyre duke funksionuar ose duke punuar me kapacitetet më të ngarkuar se zakonisht”, është shprehur Imeri. Por, pandemia nuk ka lënë pa shkakuar edhe probleme. Për shkak të këtij virusi dhe masave të ndërmarra, Imeri ka thënë se janë shtyrë projekte shumë të rëndësishme për ndërmarrjen. “Disa projekte që kanë ndikuar edhe në projektet tona, sidomos projekti i elektro-filtrave dhe denoksit, i cili është projekt i financuar nga Bashkimi Evropian, ku nënprojektet të cilat kanë qenë projektet tona jemi

detyruar që t’i shtyjme për një vit. Deri në këtë moment që po flasim realisht objektivi është që deri në vitin e ardhshëm të filloj ky projekt, i cili do të ndikoj drejtpërdrejtë në cilësinë dhe në operimin e këtij termocentrali sipas standardeve të Bashkimit Evropian në aspektin ambiental, por edhe në aspektin teknik”, ka deklaruar Imeri. Më tutje, ai ka thënë se si menaxhmenti ashtu edhe punëtorët do të vazhdojnë të angazhohen që të prodhojnë energji elektrike për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe energji termike për të gjithë banorët e Prishtinës që janë të kyçur në rrjetin e ngrrohtores.

Oda e Afarizmit kërkon nga qeveria largimin e kufizimeve të orarit të punës për bizneset

EPOKA
ERE **A.MAVRAJ**

PRISHTINË, 30 NËNTOR- Situata e shkaktuar në vend si pasojë e pandemisë Covid-19 ka bërë që sektori privat të mbetet më i goditur i në mesin e të cilëve janë edhe prodhuesit vendor dhe se gjendja e tyre ka shkuar duke u rënduar veçanërisht pas masave të fundit të marra nga Qeveria e Kosovës. Kështu është thënë në reagimin e Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK), duke kërkuar që të largohet ora policore dhe kufizimet në orar dhe të shtohen masat gjatë 24 orëve. “Arsyeja qëndron se gjatë gjithë ditës jemi duke parë qarkullim masiv të qytetarëve në shitore, rrugë dhe kafene ku nuk është duke u respektuar pothuajse asnjë rregull si numri i kufizuar në bazë të metrave katrorë në një shitore apo market, numri i kufizuar në lokale dhe largësia 2 metra nga

tavolina apo numri maksimal prej 5 personave që lejohen të jenë në një tavolinë. OAK-u rikërkon heqjen e menjëhershme të orës policore dhe kufizimeve ose mbështetje direkte për bizneset dhe punëtorët për humbjet që po u shkakton ky vendim duke i’u ndaluar të drejtën e punës, kërkesë kjo e dalë nga takimet që OAK-u që mbanë në vazhdimësi me bizneset. OAK-u kërkon sërish që çdo vendim që merret për mbyllje të biznesit duhet të shoqërohet me përkrahje financiare, në mënyrë që të ofrohet përkrahje në këtë drejtim. Rithekojmë se ne jemi të vetëdijshëm se bëhet fjalë për shëndetin tonë, mirëpo krahas shëndetit duhet të mendohet edhe për rimëkëmbjen e ekonomisë. Andaj, OAK-u rikërkon largimin e kufizimeve të deritanishme të vëna nga Qeveria e Kosovës dhe respektimin në mënyrë



restriktive të masave të parapara nga IKShPK-ja”, është thënë në reagim. Kujtojmë se ditë më parë,

Qeveria e Kosovës kishte vendosur masa kundër përhapjes së Covid-19, siç janë shkurtimi i orarit të punës për

bizneset dhe vendosja e orës policore për ato qytetet që kanë numër të lartë të infektiveve nga kjo sëmundje.

Familja Kajtazi dhuron 1 000 kilogram miell për familjet në nevojë

SKENDERAJ, 30 NËNTOR (ER) - Komuna e Skenderajt ka bërë me dije se familja e Sylejman Kajtazit nga kjo komunë ka dhuruar 1 000 kilogram miell për familjet në nevojë. Dorëzimin e këtij donacioni e ka bërë Agron Kajtazi, asamblist i Kuvendit Komunal të Skenderajt. Me këtë rast, kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, ka falënderuar familjen Kajtazi për këtë donacion. “Në emër të

qytetarëve të Skenderajt, falënderoj familjen Kajtazi për ndihmën e ofruar për qytetarët tonë”, ka deklaruar kryetari Jashari. Me propozimin e Kryetarit Jashari, javën e kaluar në Shtabin Emergjent Komunal, është marrë vendim që për fundvit, të ndahen pako ushqimore-higjienike për 1 000 familje në nevojë, të cilave u është renduar situata si pasojë e pandemisë.



Prej sot në Prishtinë trafiku urban falas



PRISHTINË, 30 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se qarkullimi me autobusët e Trafikut Urban do të jetë falas për të gjithë qytetarët

për një muaj rresht, duke filluar nga sot (e martë). “Zbatimi i të gjitha rregullave dhe masave mbrojtëse kundër Covid-19 mbeten në fuqi dhe janë të obligueshme për secilin që

udhëton me këta autobusë”, ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në “Facebook”. Ai ka kërkuar nga qytetarët të tregohen të kujdesshëm për mbrojtjen e shëndetit në kohë pandemie.

Lladrovci nënshkruan memorandum me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas

Drenas, 30 nëntor (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur në takim përfaqësuesit e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas (ANJF), me të cilët ka nënshkruar një memorandum i mirëkuptimit për mbështetjen e zyrtarëve të ndihmës juridike të kësaj agjencie.

Qëllimi i këtij memorandum është sigurimi i qasjes së barabartë në drejtësi për qytetarët, duke siguruar qëndrueshmërinë e zyrave mobile për ndihmë juridike falas, si dhe përkushtimin e palëve për mbështetjen e zyrtarëve të ndihmës juridike të ANJF-së për të kaluar në buxhetin e Kosovës nga 1 janari 2021 dhe në vazhdim.



Shefqet Abrazhda zë vendin e parë në ekspozitën çmimi ‘Kadri Kadriu’

MITROVICË, 30 NËNTOR (ER) - Nën organizimin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe në bashkëpunim me Shoqatën e Artistëve Figurativ të Mitrovicës, në Qendrën e Kulturës “Rexhep Mitrovica” është hapur edicioni i nëntë i ekspozitës mbarëkombëtare çmimi “Kadri Kadriu”, ku të pranishëm ishin shumë dashamirë të artit figurativ. Fillimisht drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci, ka përshëndetur të gjithë artistët të cilët e nderuan këtë ekspozitë e cila mbanë emrin e piktorit më të

shquar të qytetit. “Ky është edicioni i nëntë me radhë i ekspozitës mbarëkombëtare çmimi ‘Kadri Kadriu’ ku po ekspozohen punime shumë të bukura në një frymë moderne dhe po marrin pjesë autorë nga të gjitha trevat shqiptare”, ka thënë drejtori Peci. Juria profesionale, pas vlerësimit të të gjitha punimeve të arritura, vendin e parë ia ndau piktorit, Shefqet Abrazhda, vendin e dytë e ndanë për Shkurta Haxhiu, grafike, ndërsa çmimi i tretë iu dha Sabri Behramaj, skulpture.



Cironkat e korrupsionit dhe peshqit e mëdhenj, kur do ndëshkohen ata që sot e ndjejnë veten të plotfuqishëm?



Shkruan: Bedri ISLAMI

Një qytetar korçar, në rrugën e tij të zakonshme, si duket i mësuar se çdo shkelje e ligjit mund të errësohet përmes një shpërblimi, çka vërtetë ka ndodhur në të gjitha këto vite, u bë objekt i Strukturës së Posaçme Antikorrupsion (SPAK). Ai kishte provuar "të joshite" një punonjës policie duke i afruar 500 lekë për të mbyllur sytë ndaj shkeljes së tij. Nuk është e rëndësishme se cila shkelje ishte dhe se cili qytetar provoi të zgjidhte një situatë, ashtu si e kishte zgjedhur ndodhte edhe herë të tjera. Ai u përball me SPAK-un dhe u dënua me disa orë pune në shërbim të komunitetit.

Disa kohë më parë, një qytetar tjetër, ndër ata të varfrit që janë bezdi për gjykatën, pasi ishte lënë në harresë në një paraburgim të zgjatur, pasi kishte përvetësuar një shumë prej të cilës mund të jetonte ndoshta dy a tri ditë me familjen e tij, vari veten dhe shkoi nga kjo botë. Nga e gjithë trupa hetuese dhe gjyqese e tij, që e kishin harruar për rreth 40 ditë, askush nuk u dënua dhe as nuk u mor në pyetje. Jeta e atij që shkoi kishte qenë pak e vlefshme për t'u gjykuar vdekja e tij. Nëse do të kishte qenë dikush tjetër, qoftë edhe i arrestuar me bujë, si rasti i K. Gradecit, apo të fortët e Shijakut, me siguri që burgimi as nuk do të ishte në mendjen e askujt. Prokuroria Speciale nuk e kishte rastin pronë të vetën, ama qytetarin nga Korça apo nga do që të ishte, "e përvetësoi" pasi thoshte ligji!

Cili ligj?

Përse është ngritur SPAK-u? Për "cironkat" e korrupsionit apo për atë që u shpall me aq bujë: hetimin e akteve korruptive të presidentit, kryetarit të Kuvendit, kryeministrit, trupës qeveritare, elitës së drejtësisë, deputetëve, njerëzve me pushtet, të cilët janë bërë sot gangrena e këtij vendi? Rrallëherë një strukturë e posaçme është pritur me kaq padurim dhe shpresë nga njerëzit se sa Struktura e Posaçme Antikorrupsion, i njohur shkurt SPAK. Nga të gjithë, në mos më e domosdoshmja, është parë e deri diku vazhdon të ndiqet si ngrehina themelore nga e cila do të ndiqet një klasë e tërë politike, e cila, në tridhjetë vite, ndërsa u pasurua marramendshëm për vete, krijoi një humnerë mes saj

dhe njerëzve të zakonshëm.

Ka qenë shpresëdhënës momenti kur përfundoi ngritja e Strukturës së Posaçme Antikorrupsion, (SPAK). Kjo strukturë së bashku me Gjykatën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të njohur edhe si Gjykata Speciale, të ngritur pas shkrirjes së Gjykatës së Krimeve të Rënda do të hetojë dhe gjykojë të gjitha veprat penale dhe akuzat për korrupsion ndaj ish-pushtetarëve dhe atyre aktualë, që nga viti 1990 dhe në vijim. Ky është thelbi i ligjit! Hetimi e pastaj gjykimi i të gjitha veprave penale dhe akuzat për korrupsion ndaj ish pushtetarëve, atyre aktualë e që do të vijin, që nga viti 1990 dhe në vijim. Ngritja e SPAK-ut dhe Gjykatës Speciale shënon një moment të rëndësishëm, historik në progresin e reformës në drejtësi në Shqipëri.

A po kthehet "historikja" në farsë?

A duhet që ligji, nëse është i tillë të ndryshojë dhe kjo strukturë kaq e fuqishme të mos humbë kohën e saj me korrupsionin e një qytetari të zakonshëm, i cili ende e ka në vetëdijen e tij se gjërat mbyllen duke paguar nën dorë? Në Shqipëri, në tridhjetë vite, kanë ndodhur akte të mëdha të korrupsionit dhe të krimin të organizuar, qendra, ose më saktë, bërthama e të cilave kanë qenë segmente të rëndësishme të shtetit, që nga kapot e institucioneve të mëdha dhe deri tek dikasteret e sistemi i drejtësisë. Vetëm pak të heqësh "një petë lakrori" dhe mund të shikosh se çfarë fshihet në mes të petëve të tjera. Mjaftoi pak vetting në sistemin e drejtësisë dhe thujse gjysma e tyre janë jashtë sistemit, nga të cilët, fare pak, ama krejt pak, janë larguar për paaftësi. Shumica dërmuese e tyre janë dëbuar nga pasuritë e paligjshme dhe të pajustificuara që kishin grumbulluar. Disa nga këto gjykatës dhe prokurorë, pasi qëndruan deri në momentin e fundit në detyrën e tyre u vetëlarguan pikërisht kur po u vinte dita e zëbrthimit, duke synuar fshehjen e vjedhjeve që kishin bërë dhe korrupsionin e hatashëm. Dhe vjedhja e tyre ka emër, është në banesat e luksit, në pronat, në udhëtimet, që nuk kanë qenë thjeshtë për relaks, por edhe për të fshehur pasurinë, në krijimin e miniperandorive të hapura, duke fshehur të vërtetat, pronat e mëdha. Vettingu, i cili filloi keq, pasi nuk u vendosën në sprovë në fillim ata që ishin përfolur dhe që dihej se ishin ujqërit e ujkonjat e sistemit gjyqësor, por përmes një liste dosido, kap çfarë të kapësh, u dha "lirinë" gjingjonëve të drejtësisë të bëjnë çfarë të duan dhe pastaj ta përqeshin atë. Çfarë do të

bëhet me të gjitha këto llogari të hapura, të cilat kanë filluar të fshihen, që të mos sekuestrohen; të shpërndahen që të mos jenë më të dyshimta, të kthehen në transaksione të hapura, por që askush nga prokuroria speciale nuk i sheh? A mund të kërkojë dikush pas disa viteve llogari tek një gjykatës a prokuror se çfarë është bërë "me tepricat" milionëshe të pasurive të tij, të cilat në të shumtën e rasteve u deklaruan si dhurata nga motra a vëllai në mërgim, nga vjehrra e vjehrrri, e sidomos nga kunetër të paditur? Ashtu si ndodhi në rastin e ish prokurorit të përgjithshëm, Llalla, dosja e të cilit u shfry në një hollake të pavlerë dhe latifondisti që kishte bërë njëmijë e një allishverishe nesër do të përtallë pikërisht drejtësinë? Njeriu që kishte bërë veprime financiare edhe me të dënua, duke blerë prona të patundshme me çmime qesharake dhe duke i kthyer më pas në prona të vlefshme, tani i lan duart dhe sjell mosbesimin tek kjo strukturë, që nuk ishte e aftë apo nuk donte të ishte e aftë për të ngritur një kauzë serioze, të besueshme dhe të fuqishme si besim. Çfarë po bëhet me dosjet e shumëkohëshme që kanë lidhje me zgjedhjet në Durrës dhe në Dibër? Nëse 25 prilli është afër, ata mund të krijojnë një front lufte nëse gjërat nuk janë të sqaruara deri asaj kohe, front të cilin opozita mund ta krijojë edhe pa këto dosje, por që duhet të jenë të qarta, pa ndërhyrë politika

dhe pa u tallur askush me to. Disa ditë më parë në Shqipëri ndodhën disa ngjarje të bujshme, mes të cilave edhe ajo e K. Gradecit, ish-drejtori i Drejtorisë së Hidrokarbureve në AKBN, i cili është arrestuar nga policia, pasi akuzohet për shpërdorim detyre. 45-vjeçari u vendos në pranga në aeroportin e Rinasit, pasi Prokuroria kishte lëshuar disa urdhër-arrest. Gradeci kërkohet për abuzimin e 1.4 milionë euro, dhe fillimisht aksioni për arrestimin e tij dështoi, pasi operacioni për ndalimin e tij u dekonspirua mbrëmjen e kaluar, duke i shpëtuar fillimisht prangosjes. Sipas sistemit TIMS, ai rezultoi të jetë larguar nga Shqipëria në drejtim të Turqisë një ditë më parë, pikërisht disa orë para se prokuroria të firmoste urdhër-arrestet për Klodian Gradecin dhe tre zyrtarë të tjerë të AKBN, Denis Durrsi, Qani Hoxhaj, Rezarta Qose. Kthimi më pas i tij është përfolur që në krye të herës si një kompromis mes tij dhe zyrtarëve më të lartë se ai. Në shkëmbim të heshtjes atij do i krijoheshin rrethana lehtësuese, çka edhe po ndodh. Korrupsioni është i njohur në Shqipëri dhe i ka gjurmët e tij të dukshme. Mjafton të ndiqet paraja. Ajo është shndërruar përgjithësisht në prona, pasi njerëzit e politikës e ndjejnë veten të plotfuqishëm dhe jashtë çdo ndëshkimi. Si dikur anëtarët e byrosë politike. Duke qenë të tillë, në mendësi dhe në pushtet,

ata kanë krijuar atë oligarki të fuqishme që e ha shtetin dhe e mbërthen si një oktopod. Në tetë vitet e shkuara, por edhe tani, thujse çdo javë, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka bërë mesatarisht një kallëzim për ndjekje penale, por pak gjëra janë ndriçuar. Dhjetëra afera të mëdha, që nga koncesionet në shëndetësi, më të dukshmet, në ndërtimin e rrugëve, në PPP-të, koncesionet e dhëna nga opozita kur ishte në pushtet dhe nga qeverisja e tashme, të gjitha janë objekt i SPAK-ut. Dhe SPAK-u përbëhet nga njerëz konkretë. Të barabartë mes të barabartëve. Që u zgjodhën me dorë. Që u mbështetën nga të gjitha strukturat ndërkombëtare të sigurisë. Të gjithë së bashku përbëjnë një strukturë ku varet shumë besimi i njerëzve për një drejtësi ndryshe e selektive, që dënon një qytetar për 500 lekë, por nderon një qeveritar që përvetëson miliona. Nëse nuk e bën këtë, le të venë në punët e tyre. Nëse SPAK-u vazhdon të merret me cironka dhe jo me të fortët e Durrësit e të Shijakut, ku fillimisht u vendosën në sekuestro rreth 5 milionë euro, të cilat një ditë mund të jenë të lira, si ndodhi me pronat e Lulzim Berishës; nëse SPAK-u do të orientohet drejt personazheve të OFL dhe jo tek pushtetarët, çdo gjë do të jetë si më parë, vetëm se do të kemi një institucion me emër tingëllues, por të boshtë.

Ndërpritet përkohësisht qarkullimi në një pjesë të rrugës Prizren-Gjakovë

PRIZREN, 30 NËNTOR (ER) - Komuna e Prizrenit ka bërë me dije se për shkak të punimeve që po zhvillohen nga Ministria e Infrastrukturës në kuadër të projektit "Rehabilitimi i Rrugëve Rajonale", është ndërprerë përkohësisht qarkullimi i automjeteve në një pjesë të rrugës Prizren-Gjakovë. "Punimet janë duke u realizuar në segmentin e rrugës në dalje të Prizrenit, në drejtim të Gjakovës dhe rruga është e bllokuar nga 'Transiti i Vjetër' në Arbanë deri te rreth-rrotullimi në Landovicë. Të gjitha veturat që shkojnë dhe vijnë nga drejtimi i Gjakovës, udhëzohen që si rrugë alternative të kalojnë nga drejtimi i rreth rrotullimit të Autostradës në dalje nga Prizreni-Veri. Ndërprerja vlen nga data 30 nëntor deri më 15 dhjetor 2020", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Ballkani nuk gabon ndaj Arbërisë, Llapi triumfon në Drenicë

Ballkani vazhdon të tregohet skuadër e sigurt në Superligë, pasi edhe të hënën mori maksimumin e pikëve ndaj Arbërisë. Fitore të madhe në Drenicë arriti edhe skuadra e Llapit që këtë edicion ka pasur një krizë rezultatesh



pranuar dy gola në fillim të ndeshjes, mirëpo gjërat tjera kanë qenë mirë. Kemi ardhur me luajt me një ekip shumë të kompletuar, i cili deri më tashti nuk po dinë për humbje, por kemi ardhur edhe për befasi. Nëse nuk e kemi arritur befasinë me rezultat e kemi arritur me lojë”, ka thënë Morina. Pas kësaj ndeshje, Ballkani ka grumbulluar 35 pikë dhe është

në pozitën e parë, kurse Arbëria është në pozitën e shtatë me 17 pikë. Në ndeshjen tjetër që u zhvillua në stadiumin “Bajram Aliu” në Skenderaj, triumfuese doli skuadra e Llapit në përballje me Drenicën. Golin e vetëm dhe të fitores për llapjanët e shënoi Ramadani, në minutën e parafundit të kohës së rregullt. Me tri pikët e reja, Llapi ngritet në koutën e 11 pikë

SUPERLIGA		
Ballkani - Arbëria		2-1
Drenica - Llapi		0-1
Gjilani - Drita		2-1
Feronikeli - Trepça '89		2-0
Besa - Prishtina		0-2
Tabela		
		Pikë
1. Ballkani	14	35
2. Drita	13	30
3. Prishtina	14	24
4. Gjilani	14	23
5. Feronikeli	15	19
6. Drenica	14	18
7. Arbëria	15	17
8. Trepça '89	15	17
9. Llapi	14	11
10. Besa	15	6
Në xhiron e radhës takohen: Prishtina-Feronikeli, Trepça '89-Gjilani, Arbëria-Drenica, Llapi-Besa, Drita-Ballkani.		

dhe është në vendin e parafundit. Ndërsa skuadra kuqezi zë pozitën e gjashtë me 18 pikë.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Liderja e Superligës në futboll, Ballkani e ka mposhtur edhe Arbërinë (2-1), në ndeshjen e zhvilluar të hënën në kuadër të javës së 15-të. “Me thënë të drejtën Arbëria bëri paraqitje të mirë, jo vetëm në pjesën e dytë por edhe në të parën. U pa që na kishin studiuar mirë dhe komplimente atyre për lojën. Nuk i lë faj skuadrës time, por kundërshtarëve që luajtën mirë”, ka thënë pas ndeshjes Ismet Munishi, trajner i Ballkanit. Golat janë shënuar në pjesën e parë të ndeshjes.

Fillimisht në minutën e 8-të, Blend Baftiu shënoi golin e parë për vendasit, kurse për golin e dytë u përkujdes sulmuesi më i mirë në ligë, Mirilind Daku. Ky i fundit ka arritur në koutën e 20 golave në këtë edicion garash. Arbëria e shënoi golin e parë nëpërmjet Kreshnik Bahtirit dhe pjesa e parë u mbyll 2-1. Në pjesën e dytë rastet për shënim nuk munguan nga të dyja klubet, por gola të tjerë nuk pati dhe tri pikët e plota i takuan skuadrës së Ismet Munishit. Edhe përkundër humbjes, trajneri i Arbërisë, Arbnor Morina është ndarë i kënaqur me paraqitjen e skuadrës së tij. “Na mungoj koncentrimi kur i

Mezani jep dorëheqje, Sallahi merr drejtimin e Gjilanit



Humbja nga Arbëria e me pas edhe nga Drita në derbin me të madh në Kosovë ka bërë që Gentjan Mezani të jap dorëheqje nga posti i trajnerit në SC Gjilani. Sallah Sherifi do të jetë në krye të shtabit teknik për ndeshjet e radhës

“Epoka e re”

GJILAN, 30 NËNTOR - Gentjan Mezani ka jap dorëheqje nga detyra e trajnerit të SC Gjilani. Lajmi është konfirmuar nga klubi gjilanas nëpërmjet një postimi në faqen zyrtare në “Facebook”. Duket se humbja nga Drita në derbi (2-3), ka ndikuar në dorëheqjen e trajnerit nga Shqipëria. “Pas ndeshjes derbi të zhvilluar të dielën, kryesia e klubit mbajti

takim së bashku edhe me trajnerin Gentjan Mezani, ku u analizua rrjedha e deritanishme e kampionatit. Pas insistimit të trajnerit kryesia e klubit pranoi dorëheqjen e ofruar nga Gentjan Mezani, i cili edhe në periudhën kur mungoi për shkaqe familjare, kishte ofruar dorëheqje por që nuk ishte pranuar. SC Gjilani e falënderon shumë trajnerin Mezani për punën dhe rezultatet e arritura së bashku në kampionatin e kaluar. Klubi i dëshiron suksese

në karrierë Gentjan Mezani”, thuhet në njoftimin e Gjilanit. Vendin e trajnerit shqiptar pritet ta zë Sallah Sherifi, i cili e ka drejtuar me sukses Gjilanin në disa ndeshje të këtij edicioni. “Ekipin në ndeshjet në vazhdim do ta udhëheq drejtori Sportiv, Sallah Sherifi”, thuhet në njoftimin e skuadrës nga Anamorava. Pas dy humbjeve të fundit, Gjilani ka mbetur prapa skuadrave tjera në renditjen tabelore, pasi renditet në pozitën e katërt me 23 pikë.

Sonte përballja Holandë - Kosovë

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Pas ndeshjes kundër Rusisë, Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave, do të zhvillojnë edhe ndeshjen e fundit kualifikuese për “Euro 2022” kundër Holandës. Pa dyshim se përballja me kombëtaren holandeze është një sfidë tejet e vështirë për “dardanet”, të cilat me plotë

seriozitet punuan në mënyrë që ta kenë një paraqitje sa më të mirë, duke pasur parasysh nivelin e kundërshtarëve, të cilat në ndeshjen e parë në Prishtinë fituan me rezultat bindës 6:0. Ballafaqimi do të jetë tejet i vështirë e ku përveç shumë mungesave tjera në këtë ndeshje do të mungojë edhe promotorja e ekipit Erëleta

Memeti, e cila u detyrua të kthehet te skuadra e saj Freiburg pasi kishte leje vetëm për ndeshjen kundër Rusisë. Holanda i ka fituar të gjitha nëntë ndeshjet kualifikuese në Grupin A dhe prinë me 27 pikë. Kosova është e katërta me 10 pikë nga nëntë ndeshje. Ndeshja Holandë - Kosovë luhet sonte (e martë) nga ora 18:30.



Më 1 dhjetori nis faza përgatitore në NBA

WASHINGTON, 30 NËNTOR - Përmes një buletini me 134 faqe, NBA ka zyrtarizuar nisjen e fazës përgatitore për sezonin 2020-2021 duke nisur nga data 1 dhjetor. Stërvitjet do të jenë më së shumti individuale ose

maksimumi deri në 4 lojtarë (edhe 4 staf) dhe ato do të kryhen në qendrat stërvitore të skuadrave. Të gjithë do të respektojnë protokollin anti-Covid. Të gjithë basketbollistët që do të hyjnë në palestër do të

kenë të paktën 3 teste radhazi negative. Duke nisur nga data 4 dhjetor do të lejohen stërvitjet ekipore, pasi lojtarët të kenë kryer 2-3 teste anti-Covid gjatë këtyre ditëve. Siç dihet, sezoni sportiv 2020-2021 në NBA do të

nisë më 22 dhjetor dhe ekipet do të luajnë 74 ndeshje në sezonin e rregullt. Është vendosur që ekipet të bëjnë një pushim 5-ditor më datat 5-10 mars, ku pritet të zhvillohet event i "All Star Game".



Reali kërkon kualifikimin kundër Shakhtarit

DONETSK, 30 NËNTOR (ER) - Real Madrid do të synojë fitore sonte (e martë) në Ukrainë në përballje Shakhtar Donetsk në mënyrë që të sigurojë një vend në fazën e 16-të të fundit të Ligës së Kampionëve. Skuadra e Zinedine Zidane aktualisht është e dyta në Grupin B, tre pikë pas Shakhtarit që është në vendin e tretë, që do të thotë se një fitore eventuale e kësaj skuadre do t'ia sigurojë kualifikimin tutje. Shakhtarit i mjafton edhe barazimi në mënyrë që të mbajë gjallë shpresat për kualifikim edhe në ndeshjen e fundit kundër Interit. Skuadra ukrainase regjistroi një fitore të jashtëzakonshme 3-2 ndaj Realit në Madrid, kurse me pas mori edhe një pikë ndaj Interit. Mirëpo kjo skuadër regjistroi dy rezultate zhgënjyese kundër 4-0 dhe 6-0. Reali hynë në ndeshjen e së martës pas humbjes shokuese në shtëpi nga Alaves në La Liga (2-1). "Los Blancos" janë në vendin e katërt në La Liga, gjashtë pikë larg liderit Real Sociedad, por ata nuk kanë mundësi që të kalojnë këtë zhgënjimin ndërsa fitojnë në Ukrainë. Skuadra e drejtuar nga Zinedine Zidane mori një pikë nga dy ndeshjet e para në grup kundër Shakhtarit dhe Gladbachut, por më pas arriti të regjistronte fitore ndaj Interit në të dyja ndeshjet. Shakhtari do të jetë pa Yevhen Konoplyanka, Davit Khocholava, Dentinho, Viktor Korniienko dhe Ismaily për shkak të dëmtimeve. Ndërsa skuadrës mysafire i mungojnë Dani Carvajal, Luka Jović, Sergio Ramos, Eden Hazard dhe Federico Valverde, ndërsa Alvaro



Odriozola mbetet një dyshim. Në këtë grup përballen edhe Borussia Moenchengladbach-Inter. Ndeshje interesante do të zhvillohet edhe në Grupin D mes Liverpoolit dhe Ajaxit. "Reds" kanë 9 pikë, por do të mundohen të marrin maksimumin dhe të

sigurojnë pozitën e parë, kurse holandezët kërkojnë rezultat pozitiv për të ruajtur gjasat e kualifikimit. Në anën tjetër, Atalanta kërkon fitore ndaj Midtjylland për të qenë shumë afër kualifikimit në fazën tjetër të Ligës së Kampionëve.

GRUPI A			GRUPI C		
18:55 Lokomotiv M. - Salzburg			21:00 Porto - Manchester City		
21:00 Atletico M. - Bayern M.			21:00 Marseille - Olympiacos		
TABELA			Tabela		
		PIKË			PIKË
1. Bayern M.	4	12	1. Manchester City	4	12
2. Atletico M.	4	5	2. Porto	4	9
3. Lokomotiv M.	4	3	3. Olympiacos	4	3
4. Salzburg	4	1	4. Marseille	4	0
GRUPI B			Grupi D		
18:55 Shakhtar D. - Real Madrid			21:00 Atalanta - Midtjylland		
21:00 B.Moenchengladbach - Inter			21:00 Liverpool - Ajax		
Tabela			Tabela		
		PIKË			PIKË
1. B.Moenchengladbach	4	8	1. Liverpool	4	9
2. Real M.	4	7	2. Ajax	4	7
3. Shakhtar D.	4	4	3. Atalanta	4	7
4. Inter	4	2	4. Midtjylland	4	0

Futbollistja spanjolle refuzon të mbajë 1 minutë heshtje

MADRID, 30 NËNTOR - Homazhet në nderim të Diego Armando Maradonës vazhduan në të gjithë botën në fundjavën që lamë pas, ku në çdo ndeshje u mbajt një minutë heshtje si dhe lojtarët kishin vendosur dhe shirita të zi në krahë. Por ka pasur dhe nga ato që kanë refuzuar homazhet ndaj legjendës argjentinas. Konkretisht ngjarja ndodhi në ndeshjen e femrave në Spanjë mes Viajes Interrias FF dhe Deportivo Abanca, ku Paula Dapena u kthye me shpinë në momentin kur u mbajt një minutë heshtje. "Sapo zbulova



se do të kishte një veprim në homazh të tij, unë refuzova të respektoj heshtjen për një minutë për një përdhunues, pedofil apo abuzues", ka deklaruar Dapena në përfundim

të ndeshjes. Madje sipas raportimit të "PontevedraViva", spanjollja kishte dhe mbështetjen e trajnerit të ekipit kundërshtar, i cili deklaroi se e kuptonte veprimet e saj.

SHKURT

Gattuso: Interi është favoriti kryesor për 'Scudetto'

Trajneri i Napolit, Gennaro Gattuso beson se Interi është favoriti për të fituar Serie A-në këtë sezon, përpara Milanit dhe Juventusit. "Sipas mendimit tim, Interi është skuadra që duhet të mposhtet. Ata kombinojnë cilësinë me forcën fizike, kanë kaq shumë mundësi në dispozicion dhe janë favoritë. Pastaj është Juventus, i cili është mësuar të jetë atje lart", ka thënë Gattuso për "Sky Sport Italia".

Vdes ish-futbollisti i Fulhamit, Papa Diop

Ish-futbollisti senegalez i Fulhamit, Papa Diop ka vdekur në moshën 42-vjeçare. Ai ndërroi jetë pas një ballafaqimit të gjatë me sëmundjen Alzheimer. Papa Diop vdiq në Paris, kurse gjatë karrierës si futbollist regjistroi për Senegalin 63 paraqitje ku shënoi 11 gola. Diop i cili njihej për gjatësinë dhe fuqinë e tij, ka luajtur për klube si Fulham, Portsmouth, Lens dhe West Ham.

Juve planifikon transferimin e Icardit

Mauro Icardi mund të rikthehet dhe të luajë sërish në Serie A, pas aventurës së tij me Interin deri para dy viteve. Interesim për ta rikthyer sulmuesin argjentinas në Itali kanë shprehur rivalët e Interit, Milani dhe Juventus. Tani, gjithnjë sipas raporteve të fundit nga "Calciomercato", "Zonja e Vjetër" ka bërë hapa konkret drejt një marrëveshje me Paris-Saint-Germain për Icardin. Ata do t'i ofrojnë shërbimet e Paulo Dybalas në këmbim të tij, ofertë kjo e cila edhe mund t'i përshtatet klubit parisien. Dybala është në bisedime me Juventusin për rinovimin e kontratës dhe deri më tani nuk kanë gjetur ndonjë marrëveshje finale.

Haaland: Ja pse e refuzova Juven

Futbolliti i Borussia Dortmund, Erling Haaland ka zbuluar se vite me parë e ka refuzuar Juventusin. Sulmuesi norvegjez tregon se "Zonjës së Vjetër" nuk iu bashkua për shkak se ishte ende i ri dhe dëshironte të fitonte përvojë më të madhe duke luajtur në vazhdimësi. "Ata më kërkuan kur isha pjesë e Moldes, por në atë periudhë ishte shumë herët për mua për të kaluar te një klub i madh si Juventus, pasi hapësirat në formacion do i kisha të pakta. Salzburgu ishte skuadra ideale për mua në atë kohë pasi në Austri u vura në dukje dhe pata mundësinë të luaja rregullisht", ka thënë Haaland.

Mourinho: Futbollistët ishin të mërzhitur me barazimin, kjo më bën krenar

Tottenham Hotspur ndau pikët me Chelsea (0-0) në derbin e Premier Ligës. Trajneri Jose Mourinho ka thënë se ndihet krenar për faktin se futbollistët e "Spurs" ishin të pakënaqur me barazimin e arritur në "Stamford Bridge". "Gjëja më e mirë e ndeshjes së sotme ishte fakti që djemtë ishin të mërzhitur në dhomat e zhveshjes. Një pikë në 'Stamford Bridge' mund të jetë pozitive, por fakti që djemtë e mi ishin të pakënaqur më bën krenar. Mund të paraqiteshim më mirë në disa faza të lojës, patëm një shans të artë për të fituar në minutat e fundit, por në përgjithësi e kontrolloam në ndeshjen", ka thënë Mourinho.

Pensionohet Gabi

Është tërhequr nga futbolli i luajtur ish-kapiteni i Atletico Madridit, Gabi. Mesfushori veteran spanjoll mbylli karrierën në moshën 37-vjeçare duke luajtur së fundmi me Al-Sadin në Katar. Gabi ose i njohur ndryshe me emrin Gabriel Fernandez Arenas zhvilloi me fanellën e Atletico Madridit 374 ndeshje në karrierë duke fituar kampionatin spanjoll në vitin 2014, dy herë Ligën e Evropës, një Kupë Mbreti si dhe një Superkupë të Evropës. Ai shkoi dy herë në finale të Ligës së Kampionëve, por në të dyja rastet u mposht nga rivalët e Real Madridit. Gabi nuk luajti asnjëherë për Spanjën, ndërsa është futbollisti i tetë në historinë e Atletico Madridit për sa i përket numrit të ndeshjeve.



Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë



Në bazë të dispozitave të Nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike, respektivisht dispozitat e Nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë, shpall:

KONKURSET

Për pozitat:

I. Këshilltar/e i Përgjithshëm/Sekretar/e i Ndërmarrjes,

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Kandidati duhet të ketë diplomë në fushën e Fakultetit Juridik (Jurist i diplomuar ose Master në shkencë Juridike);
- Të posedojë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale nga fusha e qeverisjes, korporatave ose të drejtës së shoqërive tregtare;
- Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1. si dhe të plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2. pikat (d), (f), (j), (k), (l), të ligjit nr. 03/L-087 të ndërmarrjeve publike dhe plotësim ndryshimit të ligjit për ndërmarrjet publike nr. 04/L-111 neni 13;
- Të posedojë njohuri të punës me kompjuter;
- Provimin e Jurisprudencës;
- Njohja e gjuhës angleze;

Detvrat dhe përgjegjësitë

- Shërben si Sekretar i Bordit të Drejtorëve dhe është pikë qendrore e Komunikimit me Komisionin Komunal të Aksionarëve mbi funksionimin e ndërmarrjes NPL "Prishtina Parking" Sh. A.
- Të sigurojë përcjelljen e procedurave nga Bordi, ku bëjnë pjesë organizmi i takimeve të Bordit, Komitetet të Bordit dhe Aksionarëve dhe në bashkëpunim me Kryesuesin e Bordit bën përgatitjen dhe shpërndarjen e rendit të ditës.
- Të mbajë procesverbalin e takimeve dhe të shpërndaj ato tek Drejtorët dhe Komisionin Komunal të Aksionarëve.
- Të mbajë procesverbalin e secilës mbledhje të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga Kryesuesi i tyre) dhe të regjistrojë ato në librin e protokollit.
- Vepron si agjent i ndërmarrjes për pranimin e njoftimeve, të bëjë sigurimin e rrjedhjes së mirë të informatave brenda Bordit, Komitetet të tij dhe në mes të Bordit dhe Menaxherëve të lartë të ndërmarrjes.
- Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit të ndërmarrjes duhet të jenë në dispozicion të të gjithë Drejtorëve të Bordit dhe duhet të sigurojë që ato përputhen me procedurat e Bordit.
- Mirëmban regjistrat e të dhënave të ndërmarrjes.
- Përcjell ndryshimet ligjore, që kanë të bëjnë me ndërmarrjen duke informuar Bordin dhe Menaxhmentin e ndërmarrjes për ndryshimet si dhe përgatit udhëzime të nevojshme për Menaxhmentin në ndërmarrje.
- Kryen të gjitha arkivimet, publikimet dhe/ose zbulimet për autoritetet përkatëse, siç mund të kërkohet për ligjin për ndërmarrjet publike ose nga statuti i ndërmarrjes.
- Koordinon me KE-në përgatitjen e letrave (dokumente) për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve.
- Merret me çështje tjera të qeverisjes së ndërmarrjes sipas nevojës.

Kohëzgjatja e punësimit, të drejtat dhe obligimet përcaktohen me kontratë punësimi në kohe të caktuar për tri (3) vite me mundësi vazhdimi.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën Këshilltar/e i Përgjithshëm/Sekretar/e i Ndërmarrjes duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në e Aplikantit;
- Dëshminë e Shkollimit (Fakulteti Juridik);
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Referenca si dhe certifikatat tjera profesionale;
- Letër motivimin;
- Deklaratën nën betim (merret nënshkruhet me rastin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se tre (3) muaj);
- Kopjen e Lejes së Njoftimit.

II. Zyrtar/e Kryesor/e Financiar/e (ZKF) dhe i Thesarit,

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Shkollimi Universitar Fakulteti Ekonomik nga Fusha e Financave/kontabilitetit (Ekonomist i diplomuar ose Master në shkencat ekonomike);
- I Certifikuar me diplomë profesionale SCAAK apo ACCA apo të ngjashme;
- Të posedojë përvojë profesionale mbi pesë (5) vite nga fusha e financave dhe kontabilitetit;
- Të ketë shkathtësi kompjuterike posaçërisht mbi sistemet e avancuara në fushën e financave/kontabilitetit;
- Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1. si dhe të plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2. pikat (d), (f), (j), (k), (l), të ligjit nr. 03/L-087 të ndërmarrjeve publike dhe plotësim ndryshimit të ligjit për ndërmarrjet publike nr. 04/L-111 neni 13;
- Njohja e gjuhës angleze;

Detvrat dhe përgjegjësitë

- Është përgjegjës për zbatimin e të gjitha dispozitave financiare dhe standardeve të kontabilitetit, ligjet e aplikueshme në Kosovë të cilat rregullojnë çështjet financiare dhe aktet normative të ndërmarrjes;
- Organizon udhëheq dhe kontrollon punën e departamentit financiar;
- Mban përgjegjësi për pagesën e obligimeve financiare në pajtim me rregulloret financiare;
- Mban evidencë dhe dokumentacion të saktë për investimet dhe pagesat e ndërmarrjes;
- Përcjell dispozitat financiare në fuqi dhe literaturën profesionale dhe mban përgjegjësi nëse nuk aplikohen ligjet në fuqi;
- Kujdeset për pasurinë e ndërmarrjes, monitoron punën e komisioneve, kontrollon hyrje -daljet financiare në përgjithësi;
- Përcjell gjendjen financiare në banka dhe bashkëpunon me institucionet bankare dhe organet tjera në interes të ndërmarrjes;
- Përgatit llogaritë periodike dhe përfundimtare;
- Është përgjegjës për përgatitjen e transfereve bankare përkatësisht pagesave me dokumentacion mbështetës dhe siguron KE-në se pagesa është në rregull;

- Harton, zbaton dhe kontrollon zbatimin e procedurave financiare nga vartësit;
- Është përgjegjës të kontrollojë mbajtjen në rregull të arkivit të dokumentacionit të kontabilitetit dhe atij financiar;
- Zhvillon dhe zbaton rregullat e brendshme të kontrollit si dhe udhëzimet dhe procedurat për aktivitete si administrimi i buxhetit, menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve dhe mbajtja e llogarive;
- Është përgjegjës për rregullsinë e proceseve në funksionin e kontabilitetit në kompani, përgatit dhe zbaton procedurat e kontabilitetit sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë, si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare të kompanisë brenda ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Të përgatis të dhënat e ndërmarrjes për auditim;
- Mbanë përgjegjësi për kryerjen e regjistrimeve dhe barazimeve të pasurisë së Ndërmarrjes;
- Përgatit raportet periodike dhe vjetore të Ndërmarrjes për KE dhe Bordin e Drejtorëve.
- Ushtron kujdes për ecurinë e shpenzimeve të Ndërmarrjes, pagesën e obligimeve Ligjore dhe afarizmin e Ndërmarrjes;
- ZKFTH i raporton KE-së si dhe Bordit të Drejtorëve;
- Kryen edhe punë të tjera, për të cilat autorizohet nga KE dhe Bordi i Drejtorëve.

Kohëzgjatja e punësimit, të drejtat dhe obligimet përcaktohen me kontratë punësimi në kohe të caktuar për tri (3) vite me mundësi vazhdimi.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën Zyrtar/e Kryesor/e Financiar/e (ZKF) dhe i Thesarit duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në e Aplikantit;
- Dëshminë e Shkollimit (Fakulteti Ekonomik);
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Referenca si dhe certifikatat tjera profesionale;
- Letër motivimin;
- Deklaratën nën betim (merret nënshkruhet me rastin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se tre (3) muaj);
- Kopjen e Lejes së Njoftimit.

III. Zyrtar/e për Auditim

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Shkollimi Universitar Fakulteti Ekonomik nga Fusha e Financave/kontabilitetit (Ekonomist i diplomuar ose Master në shkencat ekonomike);
- Përvoja e punës mbi pesë (5) vite në pozita menaxhuese të auditimit pas diplomimit;
- Të Jetë i licencuar për auditor (SCAAK, ACCA) apo të ngjashme;
- Njohja e gjuhës angleze;
- Njohja e mire e punë me kompjuter (MC Office)

Detvrat dhe përgjegjësitë

- Rregullisht shqyrton gjendjen financiare të ndërmarrjes, kërkesat e planifikuara financiare dhe përmes vërejtjeve apo sugjerimeve njofton Komisionin e Auditimit kur e konsideron të nevojshme.
- Rregullisht e verifikon funksionimin e rregullt të kontrolleve të brendshme dhe nëse e konsideron të nevojshme njofton Komisionin e Auditimit përmes vërejtjeve apo sugjerimeve me shkrim.
- Rregullisht verifikon përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të punës të cilat kanë për qëllim të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i ndërmarrjes duke përfshirë dokumentacionin financiar mbahen në pajtim me standardet e kontabilitetit dhe ligjet në fuqi. Kujdes të veçantë ushtron që projekt – deklaratat financiare vjetore të përgatit në mënyrë të rregullt dhe lidhur me këtë të raportoj Komisionit të Auditimit kur e konsideron të nevojshëm.
- Verifikon përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat garantojnë se ndërmarrja zbaton standardet dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.
- Kryen vlerësim të pavarur të efikasitetit të politikave, procedurave dhe standardeve përmes të cilave bëhet menaxhimi i resurseve financiare, fizike dhe informative të ndërmarrjes.
- Përcakton llojin dhe tekniken e auditimit të brendshme për secilin rast konkret duke u bazuar në ligjet pozitive, aktet normative praktiken e mire dhe njohurit profesionale.
- Koordinon mënyrën e bashkëpunimit me auditorët e jashtëm dhe kujdeset që palët të jenë në dijeni, siguron dokumentacionin e nevojshëm dhe raporton për fushat gjegjëse, financiare dhe te prokurimit por duke pasur për baze konfidencialitetin.
- Propozon masat që duhet të ndërmirë nga ndërmarrja për ngritjen e efikasitetit dhe zbatimit të rregullave gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.
- Zbaton të gjitha rregullat dhe standardet të cilat kanë të bëjnë me auditimin e brendshme duke i raportuar KE-së, Komisionit të Auditimit dhe Bordit të Drejtorëve.
- Duhet të demonstroj integritet personal dhe profesional duke bashkëpunuar me menaxhmentin, Komisionin e Auditimit dhe KE-në.
- Kryen edhe punë të tjera për të cilat kërkohet nga menaxhmenti dhe Komisioni i Auditimit.

Kohëzgjatja e punësimit, të drejtat dhe obligimet përcaktohen me kontratë punësimi në kohe të caktuar për tri (3) vite me mundësi vazhdimi.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën Zyrtar/e për Auditim duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në e Aplikantit;
- Dëshminë e Shkollimit (Fakulteti Ekonomik);
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Certifikatë për auditor të licencuar;
- Referenca si dhe certifikatat tjera profesionale;
- Letër motivimin;
- Deklaratën nën betim (merret nënshkruhet me rastin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se tre (3) muaj);
- Kopjen e Lejes së Njoftimit.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: **Komuna e Prishtinës (Objekti i vjetër), Rr. "UÇK", nr. 2, Prishtinë.** Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë. Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen. **Konkursi është i hapur nga data: 01 Dhjetor 2020 – 21 Dhjetor 2020 ora 16:00.**

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “T Accounting” SH.P.K. me seli në Gllogoc, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 810007212 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “T Accounting” DO.O. Gllogoc, donelo odluku o prestani rada sa nr. 810007212, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “T Accounting” L.L.C. in Gllogoc, has come to the decision to quit its nr. 810007212 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► D.P.Z. “Gedore” me seli në Prishtinë, me numër të biznesit: 71157342, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: 601251549

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

